

Pak minuta ne kembet e YJEVE KUQ E Zi

nga Gent Mebelli
E diel, 14 Prill 2024 00:00

Pak minuta ne kembet e YJEVE KUQ E Zi



Armando Broja, eshte aktivizuar te Fulhamit vetem 10 minuta, duke u lene pothuajse gjithë kohes ne tribune trajneri Silva.

Jasir Asani, eshte aktivizuar vetem 8 minuta duke u lene serish kete fundjave jashte ekipit te Guangju, qe ka humbur per te pesten here rradhazi ne kampionatin e Korese se Jugut.

Mario Mitaj, lojtar me kualitet dhe cilesi te padiskutueshme, te cilat i tregoi ne te gjitha ndeshjet me Kombetaren, ka marre shume pak minuta nga trajneri Galaktionov ne tre ndeshjet e fundit me Lokomotiven e Moskes

Nedim Bajrami, javen e kaluar mbas nje goli dhe nje assist-i, ne Salernitana u shpall

„Man of the Match. Ne ndeshjen kunder Milan-it qendroi ne stol, pasi nuk u preferua nga trajneri Ballardini, megjithese mesfushori i ka shenuar pothuajse te gjithë ekipeve te medha, duke bere kundra tyre paraqitje shume pozitive.

Fakti qe shume lojtare te Kombetares nuk po marrin minutat e duhura ne Kampionatet e vendeve ku luajne, eshte shume shqetesues jo vetem stafin drejtues dhe trajnerin Sylvinho,

Pak minuta ne kembet e YJEVE KUQ E ZI

nga Gent Mebelli
E diel, 14 Prill 2024 00:00

por edhe per shqiptaret anembane botes.

Ne te gjithë shpresojne qe yjet e „ ENDRRES KUQ E ZI „ te jene ne formen e tyre me te mire per EURO 2024 ne Gjermani.

Gent Mebelli